



Republika e Kosovs
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 2.5.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Igor Simiq, Nezir Çoçaj dhe Shkumbin Demaliaj.

Munguan: Bilall Sherifi dhe Glauk Konjufca.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu dhe Edita Tahiri, EUSR/EV; Shkëlqim Nuredini dhe Çlirim Nuredini, studentë të Fakultetit Juridik; Luljeta Aliu, Iniciativa për Drejtësi; Valbona Bytyçi, Ekonomia Online; Liridon Gashi, SEEF; Alban Bajrami, Kuvendi i Kosovës; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve; Valmira Saraçi, KTV; Besim Morina dhe Valon Kurtaj, Akademia e Drejtësisë.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 6, 19, 29.3.2018 dhe 3.4.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit;

5. Diskutim lidhur me nismën e komisionit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime për të diskutuar në diskutuar në pikën të ndryshme për Projekt-Rregulloren e Kuvendit.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 6, 19, 29.3.2018 dhe 3.4.2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjet të mbajtura më datë 6, 19, 29.3.2018 dhe 3.4.2018, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin vjetor të punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017 dhe ia dha fjalën drejtorit të Akademisë së Drejtësisë, për të paraqitur raportin.

Valon Kurtaj, tha se e veçanta e këtij viti ka qenë hyrja në fuqi e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, me të cilin transformohet Instituti Gjyqësor i Kosovës në Akademi të Drejtësisë. Procesi i transformimit është përcjellë me një sërë hapash, qoftë me konstituimin e organeve të reja apo edhe me nxjerrjen e akteve normative, siç është përcaktuar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, sikurse edhe me aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me funksionalizimin e institucionit në përgjithësi. Në mandatin e saj, përveç që është marrë me trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe të stafit të administratës së gjykatave dhe prokurorive, me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, ka kompetencë të bëjë edhe trajnimin për profesionet e lira, duke përfshirë përmbarues, noterë, administrues falimentimi etj. Gjatë vitit 2017, Akademia e Drejtësisë ka pasur edhe trajnim të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë, ku u përfshin 1901 veta. Nga ky numër, 1.168 ishin gjyqtarë, 340 prokurorë dhe 393 ishin pjesëmarrës tjerë, si bashkëpunëtorë profesionalë, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, avokatë, zyrtarë të Policisë së Kosovës, Shërbimi Sprovues, Dogana, Administrata Tatimore etj. Nga këta pjesëmarrës, 1657 ishin shqiptarë, 244 përfaqësues të minoriteteve. Sipas strukturës gjinore, 1172 pjesëmarrës ishin meshkuj dhe 729 femra. Po ashtu, gjatë vitit 2017, në Akademinë e Drejtësisë, trajnimin fillestar e kanë ndjekur gjenerata e gjashtë e sapoemëruar e gjyqtarëve dhe e prokurorëve të shtetit. Trajnimi është realizuar ndaras për gjyqtarë dhe për prokurorë të shtetit. Përfitues të këtij trajnimi ishin 16 prokurorë të shtetit, prej tyre 5 femra dhe 11 meshkuj dhe 49 gjyqtarë të sapoemëruar, prej tyre 11 femra dhe 38 meshkuj. Gjithashtu, komponentë e rëndësishme për zhvillimin profesional të sistemit gjyqësor është Programi për Hulumtime dhe Publikime, i cili ka bërë hulumtime, publikime dhe analiza, njëkohësisht, në kuadër të këtij sektori, vepron edhe Biblioteka e Akademisë, në formë elektronike dhe fizike, ku mund t'i shfrytëzojnë gjyqtarët dhe prokurorët, në përgjithësi. Sipas veglës "Google Analytics", që mund të gjenerojë të dhënat, në vitin 2016 kanë qenë 1870 shfrytëzues, ndërsa në vitin 2017 është 6767. Akademia e Drejtësisë ka në

funkcion platformën e mësimit në distancë (e-learnig), e cila përmes moduleve të zhvilluara përmbush kërkesat dhe nevojat për trajnime për gjyqtarë, prokurorë, në këto kurse trajnimi: Drejtësia për fëmijë; ndërmjetësimi, aspekti civil dhe penal; anglishtja ligjore për prokurorët e sapoemëruar, teknologjia informative për prokurorët e sapoemëruar; menaxhimi i stresit për prokurorët e sapoemëruar dhe teknologjia për personelin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Duhet theksuar, se Akademia në kuadër të saj, organizon edhe trajnime për trajnues. Ndërkohë në Akademi funksionon edhe Departamenti për Administratë dhe Financa, ku përfshihen burimet njerëzore, financat, prokurimin publik, teknologjia informative dhe logjistike. Sa i përket buxhetit, si kategori kryesore, kemi këto kategori ekonomike, paga dhe mëditjet, mallra dhe shërbime, shpenzimet komunale, kapitale. Te paga dhe mëditje, ka qenë 204,383.99 euro, e i njëjtë ka qenë edhe buxheti fillestar. Te mallra dhe shërbime, buxheti ishte 430,000.00 euro, ku 55,428.00 euro janë reduktim i buxhetit, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë i shpenzuar 374,571.95 euro. Shpenzimet komunale kanë qenë 10,258.42 euro, nga 14,500.00 euro, sa kanë qenë të planifikuara. Më tej, z. Kurtaj, tha se pati edhe donacione të realizuara, me ç' rast Akademia e Drejtësisë ka përfituar nga Këshilli i Evropës, GIZ-i, UNDP-ja, Ambasada e SHBA-së etj. Si sfida të Akademisë së Drejtësisë u përmendën, reforma për edukimin ligjor dhe transformimi i IGJK-së në Akademi të Drejtësisë, sigurimi i buxhetit sipas planifikimeve të përcaktuara në programet trajnuese, hartimi dhe zbatimi i programeve trajnuese në mbështetje të reformave të sistemit gjyqësor e prokurorial, mungesa e ndërtesës së Akademisë, koordinimi i pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnimin e vazhdueshëm, koordinimi i programeve të ndryshme me donatorë, organizimi i programeve të shkëmbimit, numri jo i mjaftueshëm i stafit, sipas numrit të miratuar profesional dhe largimi i stafit etj. Ndërsa, si rekomandime u theksuan, ndarja e tokës dhe buxhetit për ndërtimin e ndërtesës së Akademisë, ndarja e buxhetit sipas kërkesës buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave, rritja e numrit të punësuarve në përmbushje të mandatit të saj dhe pranimi i statusit të ngjashëm të të punësuarve në Akademi, me ata të punësuar në sistem gjyqësor.

Korab Sejdiu, tha se në raportin e vitit të kaluar, sfidë ka qenë edhe punësimi i zyrtarëve ligjorë. Lidhur me këtë, pyeti: a janë punësuar këta zyrtarë ligjorë? Po ashtu, çfarë qasje keni për vlerësimin e nevojave të trajnimit të gjyqësorit, pra ku është nevoja për trajnime dhe sa keni kapacitet për të përmbushur këto nevoja nga të gjitha lëmit, qofshin penale, civile apo administrative?

Kryetarja theksoi faktin se vitin e kaluar, në emër të komisionit i kam shkruar Ministrisë së Administratës Publike, lidhur me objektin, që ju e dispononi me qira dhe në vend që ato mjete të shfrytëzohen diku tjetër, ju po detyroheni të paguani shuma të mëdha për objektin që e keni në shfrytëzim. Unë kam kërkuar që në qoftë se nuk ka buxhet për ndërtimin e një objekti të ri, të ndahet një objekt publik për Akademinë e Drejtësisë. Por, më është thënë se aktualisht nuk ka objekt të lirë, por janë duke punuar që të ndërtohet një objekt i ri. Shqetësimi i znj. Haxhiu ishte te trajnimet e vazhdueshme, sepse nuk po ndiqen trajnimet, siç e përcakton ligji, duke pohuar se është dhënë si vërejtje edhe në raportin për vendin, sepse aty kërkohet që të ketë trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët, sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, shqetësim tjetër i znj. Haxhiu ka të bëjë me qasjen gjyqtarëve dhe prokurorëve në raport me dhunën në familje, si dhe me pakon ligjore për trashëgiminë apo për Ligjin për familjen, sepse mendësia jonë patriarkale po dominon edhe te gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët me vetëdije po i diskriminojnë

vajzat dhe gratë, në raport me të drejtat e tyre, andaj është e rëndësishme që trajnimet të bëhen të veçanta, në vazhdimësi, për këto raste. Ndërkaq, a mund të na tregoni, sa është buxheti dhe është i mjaftueshëm që ju t'i kryeni detyrat, ashtu siç e përcakton legjislacioni në fuqi dhe çfarë ka ndodhur me gjyqtarët e integruar, të cilat janë rekrutuar së fundi për pjesën veriore, a i kanë ndjekur trajnimet fillestare apo të vazhdueshme në Akademinë e Drejtësisë? Kur gjyqtarët dhe prokurorët i kryejnë këto trajnime, a i nënshtrohen ndonjë provimi, brenda Akademisë së Drejtësisë apo KGJK-ja, apo KPK-ja e ka këtë kompetencë dhe cilat kanë qenë masat që mund të merren, nëse nuk e kanë kryer me sukses provimin?

Sami Kurteshi, pyeti: Kush ka qasje në bibliotekën elektronike dhe a është e hapur apo është e mbyllur për qarqe të caktuara të funksioneve të njerëzve? Kush i mban trajnimet dhe çfarë profilesh kanë ata persona, kush i përzgjedh? Cilat kategori të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet t'i ndjekin trajnimet? Më tej, z. Kurteshi shtoi se vendimet e gjykatave të të gjitha niveleve, asnjë gjyqtar nuk merret me trajtimin e parimit të proporcionalitetit, duke pohuar se një vendim për sanksione ligjore duhet të përmbajë parimin e proporcionalitetit, sepse është ndër parimet kryesore të Kushtetutës. Në fund, z. Kurteshi pyeti: A i keni kontratat e punës me përshkrim të saktë të punës, sepse ka kontrata të punës me përshkrime të përgjithësuara.

Hajdar Beqa, tha se kryesisht janë sfida të vitit të kaluar, të cilat i kemi dëgjuar edhe në raportin e vitit 2016, por më intereson të di se sa janë profesionist trajnuesit për gjyqtarë dhe prokurorë dhe me çfarë procedure angazhohen? Rekomandimet e vitit të kaluar të zyrës së auditorit, shihet qartë se nuk janë zbatuar mjaftueshëm, sidomos te mbulimi i pozitave me ushtrues detyre, përshkrimi i emërimit me detyrat që ka apo ka më shumë ushtrues detyre sesa e lejon ligji përkatës. A keni marrë hapa konkretë për rritje të stafit, derisa një kohë të gjatë keni pasur pozita me ushtrues detyre? Gjithashtu, te ndarja e buxhetit, a keni pasur ndonjë analizë konkrete dhe për objektin, a keni bërë ndonjë studim të fizibilitetit? Po ashtu, a keni bërë kërkesë buxhetore për ndarje të buxhetit në Ministrinë e Financave? Në fund, tha se komisioni iu mbështet, por duhet pasur një analizë konkrete se çfarë po kërkohet në lidhje me ndërtimin e objektit.

Shkumbin Demaliaj, tha se jemi në fazë e shqyrtimit në grup të punës për Projekt-Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Lidhur me këtë, pyeti: A ka trajnime për gjyqtarë të specializuar për të mitur?

Nezir Çoçaj, tha se është për t'u vlerësuar numri rritjes së shfrytëzuesve të bibliotekës elektronike. Po ashtu, z. Çoçaj pyeti: Përmes mësimit në distancë, a mund të ketë trajnime edhe nga organizatat tjera që veprojnë, të cilat kanë përvojë në fushën e drejtësisë, sepse mund të jetë diçka më e mirë në trendin e bashkëkohores? Sa është numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve që punojnë si profesorë universitarë, duke pohuar se ka shumë policë, prokurorë dhe gjyqtarë që punojnë në universitete dhe e nuk e di a ka në ndonjë shtet përqindje me numër kaq të madh, ndaj a ju ndihmojnë ata me profesionalizmin e vet, duke pasur punë me studentë, me studime postdiplomike? Ndërkohë, a i merrni parasysh, pasi që kanë një përvojë me trajnime, me mësime dhe a e ndihmojnë Akademinë dhe sa është numri i tyre? Më tej, tha se qasja e ministrit aktual të Drejtësisë ka qenë një qasje shumë pozitive me institucionet, që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë, në lidhje me rritjen e buxhetit për këto institucione. Edhe ne si komision kemi bërë përpjekje maksimale që të rritet buxheti i institucioneve që raportojnë në komision, në mënyrë që edhe zgjidhja e problemeve të jetë më e lehtë. Në fund, z. Çoçaj pyeti: A është shumë

e nevojshme që kërkohet për të zhvilluar aktivitet e mirëfillta, siç e parasheh plani vjetor i punës së Akademisë së Drejtësisë, me stafin mbështetës që e keni?

Valon Kurtaj, tha se në kuadër të numrit për rritjen e stafit, kemi paraparë edhe zyrtarë ligjorë, sepse jemi në mungesë të tyre. Sa i përket nevojave për trajnime, tha se Akademia e Drejtësisë ka programin e trajnimit vjetor, duke theksuar se për këtë vit jemi në zhvillim të idesë që të kemi një program kornizë, për pakon e tre viteve të ardhshme, me specifika të caktuara. Akademia e Drejtësisë i mbledh nevojat për gjyqtarët, prokurorët, institucionet e ndryshme, donatorë, organizata të ndryshme, me projekte që i paraqesin në Akademi, si p.sh. OSBE, UNICEF për fëmijë, përfaqësuesit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe shumë projekte të tjera. Të gjitha këto kërkesa, ne i marrim dhe i shqyrtojmë, ku formohet komisioni, i cili bën hartimin profesional të programit të trajnimeve, ku në bazë të kërkesa të gjyqtarëve, prokurorëve dhe kërkesave që dalin nga akte të ndryshme, që Republika jonë ka detyrime për trajnime për fusha të caktuara. Të gjitha këto i marrim në konsideratë dhe në fund hartojmë një program trajnimi njëvjeçar.

Korab Sejdiu, pyeti: A ka mundësi që Akademia e Drejtësisë të bëjë vlerësim të jashtëm? Pra, jo vetëm çfarë kërkojnë gjyqtarët, ku janë nevojat, sepse nganjëherë gjyqtarët nuk mund t'i shohin ngecjet që ata mund t'i kenë, me theks të veçantë, mënyrën sesi i caktojnë, formulojnë vendimet gjyqësore.

Valon Kurtaj, tha se Akademia bën vlerësimin e kërkesave, jo vetëm duke u bazuar në kërkesat e gjyqtarëve, por edhe nevojave që kanë dalë edhe për hartimin dhe shkrimin ligjor, ku Akademia, në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së, ka hartuar një modul, por edhe një udhëzues me shkrim dhe arsyetim ligjor. Sa i përket çështjes së referimit të gjykatave, në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ne si Akademi e Drejtësisë, në programin e trajnimeve, kemi trajnime që i dedikohen praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Njëkohësisht, janë mbajtur trajnime edhe me OSBE-në dhe me aktorë të tjerë që kanë ndihmuar sesi ne t'iu qasemi edhe arkivave të atyre gjykatave, përmes faqes së tyre dhe sesi ne më lehtë mund t'i gjejmë vendimet. Po ashtu, z. Kurtaj foli edhe për vizitën në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me një grup të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe njëkohësisht kanë pasur mundësi të shohin sesi aty mbahet një gjykim në funksion të asaj për ngritjet e kapaciteteve për gjyqtarë dhe prokurorë, që të përfitojmë nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por njëkohësisht, t'i qasen vendimeve, duke iu referuar këtyre vendimeve. Ndërsa, në lidhje me objektin e Akademisë së Drejtësisë, parcela është ndarë nga Ministria e Administratës Publike, ku na kanë mundësuar që pa asnjë shpenzim, të hartohet projekti ose plani i ndërtesës, i cili është në fazën e përfundimit nga MAP.

Sa i përket trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kemi pjesëmarrje aktive, mirëpo është edhe shqetësimi se ndoshta, disa edhe prej ngarkesës në punë, nuk kanë pasur mundësi që të marrin pjesë në trajnime. Mirëpo, nga ky vit, qasja në këtë fushë do të ndryshojë, sepse në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe me Këshillin Prokurorial të Kosovës, ata e kanë vënë në fuqi rregulloren e tyre për trajnime të detyrueshme, e cila nuk është masë disiplinore ndëshkuese, por është me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga viti i ardhshëm, 20 % e trajnimeve të detyrueshme do t'i dedikohet Kodit të Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu, Akademia iu ka kushtuar rëndësi dhe kujdes të veçantë trajnimeve për dhunën në familje dhe përgatitjes profesionalisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, edhe çështjes së trashëgimisë, si çështje civile në Procedurën Civile, i kemi trajnimet lidhur me këtë çështje dhe bëhen në mënyrë të vazhdueshme.

Kryetarja, tha se duhet të shtohen trajnimet e tilla dhe duhet të keni qasje më të ashpër, në raport me këto raste, për faktin se Akademia merret me trajnimet e tilla, sepse pastaj nuk po reflekton te puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, theksoi se kemi raste të shumta se si trajtohen rastet e dhunës në familje me theks të veçantë rastet e dhunës fizike ndaj grave që përfundojnë madje dhe me vrasje, duke pohuar se ka raste kur vetë gjyqtari i thotë gruas që ndoshta është më mirë të hiqni dorë nga pasuria, për shkak se është turp që të marrin gratë dhe vajzat trashëgiminë, andaj duhet t'i jepet rëndësi më e madhe këtyre trajnimeve.

Arben Gashi, pyeti: Si bëhet përzgjedhja e trajnerëve dhe cili është procesi i trajnimit të trajnerëve? Trajnuesi, a është i përgatitur me trajnim dhe çfarë përgatitje akademike dhe praktike ka ai?

Valon Kurtaj, sqaroi mënyrën e përzgjedhjes së trajnuesve, që janë përcaktuar në rregulloren e brendshme kriteret dhe kushtet për trajnues. Trajnuesit aplikojnë për tema të caktuara, ku mbledhet komisioni, i cili bën shqyrtimin e dokumenteve të dorëzuara, ku më pas i referohet Këshillit të programit të Akademisë së Drejtësisë, dhe në fund, Këshilli e jep fjalën përfundimtare për listën e trajnuesve. Në fund, përpunohet lista finale me trajnuesit e sferave të caktuara, ku në mesin e trajnuesve, kemi gjyqtarë, prokurorë, akademikë të universitetit dhe profesorë. Po ashtu, ka edhe gjyqtarë dhe prokurorë, që janë njëkohësisht edhe profesorë nëpër universitete private. Po ashtu, kemi edhe profesionistë të fushave të caktuara, si për shembull kemi edhe prej ministrisë, inteligjencës financiare, që në sferën e tyre, japin kontributin e tyre. Kemi edhe profesorë të angazhuar, që marrin pjesë në trajnime dhe që nuk i përkasin sferës profesionale gjyqësore dhe prokuroriale, si menaxhimi i stresit dhe fusha tjera. Sa i përket trajnimit për trajnues, ne mbajmë trajnime për të gjitha këto sfera, sidomos në sferën e teknologjisë së mësimdhënies për të rritur. Ndërsa, sa i përket buxhetit, duhet të bëjmë një analizë se sa buxhet na nevojitet dhe më pas i drejtohem Ministrisë së Financave, me kërkesë. Në bazë të ligjit, gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar, pasi përfundojnë trajnimin fillestar prej 12 muajsh i nënshtrohen një testi përfundimtar, dhe në bazë të rezultateve të atij testi, atyre do t'iu jepen lëndë në punë apo nuk do t'iu jepen. Nëse ata nuk kanë sukses në test, ligji e parasheh që ata të kthehen edhe njëherë në trajnime, në periudhën prej 6 muajsh dhe në fusha të caktuara ku ata kanë ngecur në ngritjen e kapacitetit të tyre, në mënyrë që t'u besohen lëndë. Ndërkaq, biblioteka elektronike është në shërbim të gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe stafi brenda gjykatave dhe prokurorive.

Arben Gashi, pyeti për mundësinë e zgjerimit të qasjes në bibliotekën elektronike dhe për që çështjen e përgatitjes dhe certifikimit të provimit të jurisprudencës, që të kalojë në kuadër të Akademisë apo të vazhdojë të jenë i pavarur. Po ashtu, qasja në bibliotekë elektronike, a mendoni se do të ishte më mirë, që edhe juristët tjerë, si përmbarues, ndërmjetësues, avokatë, përmes një pagese mujore apo vjetore, të kenë qasje, sepse mund të krijojnë të hyra për ju, por të njëjtën kohë e zgjeron gamën e njerëzve që mund të kenë qasje në literaturë.

Valon Kurtaj, tha se ka shtete të huaja që e mbajnë provimin e jurisprudencës, në kuadër të Akademisë së Drejtësisë, por ka edhe organizime që gjyqtarë dhe prokurorë, që shkojnë drejtpërdrejt në Akademi të Drejtësisë. Në bazë të stafit që e kemi dhe në bazë të punës që e bëjmë me vite në atë institucion, Akademia ka kapacitete të organizojë provimin e jurisprudencës dhe nuk e shoh asnjë problem. Ndërsa, sa i përket platformës “e-learning” me ligjin e ri e kemi edhe trajnimin e noterëve, përmbaruesve privatë dhe nuk besoj që do ishte problem, pasi që edhe

me qenë një pagesë solidare, i jepet një “password” edhe ka qasje. Akademia i angazhon trajnuesit në fusha të caktuara profesionale prej nivelit themelor, ku ne e bëjmë këtë proces të përzgjedhjes.

Arben Gashi, sërish pyeti: A ka trajnime me masën e sigurisë që u jepet të pandehurve në procedurë, sepse ndoshta njerëzit po dërgohen kot nëpër burgje, kur dihet që kjo ka kosto goxha të lartë?

Valon Kurtaj, tha se Akademia e Drejtësisë në programin e trajnimeve të veta e mbulon këtë fushë ku jemi munduar shumë ta kombinojmë edhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të bëhemi gardian të mbrojtjes së drejtave të njeriut, sidomos paraburgimin si një çështje më e ndeshme e kufizimit të lirisë së qytetarit. Ndërkaq, është bërë integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, me marrëveshjen që është arritur në Bruksel. Ne si Akademi e Drejtësisë, menjëherë pas integritit të tyre, e kemi mbajtur 10 lloje trajnimesh hyrëse, i cili është mbajtur për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët serbë në lëmin civil dhe penal, që dallon prej trajnimit që është aktualisht me ligj, por është trajnim të cilin ua kemi dedikuar atyre, në kuadër të programit. Kjo mbulohet me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, me trajnime të vazhdueshme. Ne si Akademi nuk vendosim se kush shkon në trajnim fillestar apo jo, mirëpo ne veprojmë në bazë të kërkesave të dy këshillave, ku kanë bërë kërkesë që atyre t’iu mbahet një trajnim që të informohen me ndryshimet në sistem, meqenëse ata kanë punuar më parë në sistem të drejtësisë. Pra, kemi vepruar në bazë të kërkesave të dy këshillave, ku na i kanë dërguar emrat e secilit se kush duhet t’i ndjekin trajnimet fillestare nga prokurorët dhe gjyqtarëve të integruar. Sa i përket rekomandimeve të auditorit, një pjesë të tyre e kemi përbushur, një pjesë tjetër jemi në vazhdim të përbushjes. Akademia e Drejtësisë, njëkohësisht me Komisionin Rregullativ, i cili është formuar në Akademi të Drejtësisë nga Këshilli Drejtues, është duke e hartuar rregulloren për organizimin e brendshëm, ashtu si e kërkon Ligji për Akademinë e Drejtësisë. Ndërsa, përshkrimi i vendeve të punës është përbushur si kriter dhe aktemërimet me detyra janë të harmonizuara dhe këtë vit pasi është bërë auditimi, auditori nuk ka dhënë rekomandime. Z. Kurtaj, tha se sa i përket drejtësisë për fëmijë kemi dhënë trajnime në këtë fushë dhe në harmoni me ndryshimet që po ndodhin edhe me kodin e ri, jemi duke bërë rishikimin e modulit tonë dhe kurrikulës trajnuese. Sa i përket platformës “e-learning” dhe në bazë të vizitave që kemi pasur për bashkëpunim, mund të them se në lidhje me këtë, ne si Akademi e Drejtësisë, jemi më përpara se vendet e rajonit edhe me shfrytëzim, program dhe funksionalitet. Si sfidë të madhe me këtë program është përkthimi, por përmes donatorëve jemi munduar ta mbulojmë këtë fushë.

Sami Kurteshi, sqaroi se në asnjë vendim të gjykatave të Republikës së Kosovës, nuk ka arsyetim të bazuar në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, në asnjë vendim, në asnjë rast, nuk trajtohet sipas parimit të proporcionalitetit, duke pohuar që këto janë dy baza të vendimeve gjyqësore në Republikën e Kosovës që nuk respektohen.

Valon Kurtaj, informoi se me reformën administrative që do të ndërmerren në Republikën e Kosovës, kam parë që disa institucione që i raportojnë Kuvendit, të cilat janë të pavarura, sikur Akademia, do të shuhen ose do të transformohen si pjesë e sektorit ekzekutiv.

Kryetarja, tha se në qoftë se është tendenca për ta shuar Akademinë e Drejtësisë, apo ta lënë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë apo Qeverisë, mendoj që kjo është e papranueshme, por gjithsesi mendoj se për këtë duhet një diskutim më gjerë dhe jam dakord që provimin e jurisprudencës duhet marrë tek Akademia e Drejtësisë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me 7 vota për, 1 votë abstenim, nxori këtë:

Rekomandim

Të miratohet Raporti i punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit dhe tha se Komisioni funksional ka përgatitur raportin me amendamente, me gjithsej 38 amendamente, ku disa janë teknike dhe disa gjuhësore, por nuk kam vërejtur ndonjë problem dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Sami Kurteshi, tha se vërejtjen kryesore që e kam në këtë ligj është se shërbimet e administratës publike, të ndërmarrjeve publike nuk hyjnë këtu si shërbime ndaj konsumatorit dhe krejt ligji e trajton shumë pak çështjen e përmirësimit të administratës publike dhe ndërmarrjeve publike. Pra, shkon në disa ndërmarrje publike ose në ndonjë institucion, paguan dhe nuk të lëshon kupon fiskal, sepse nuk ka transparencë. Kjo është vërejtja ime kryesorë, që nuk ka përgjegjësi të administratës publike, të themi pjesës ekzekutive të politikës ndaj konsumatorit.

Hajdar Beqa, tha se amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional janë në harmoni me Kushtetutën dhe ne duhet t'i procedojmë më tutje për seancë, ndonëse vërejtja e z. Kurteshi është me vend.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me 6 vota për dhe 2 vota kundër, vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit, është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Diskutim lidhur me nismën e komisionit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës

Kryetarja paraqiti për shqyrtim diskutimin në lidhje me nismën e Komisionit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Arben Gashi, tha se mendoj që kjo praktika e emërimit në ligj, i Kosovës, të Kosovës, dihet që ligjet që na i nxjerrim kanë fuqi vepruese vetëm në Kosovë dhe askund tjetër, andaj pse duhet me

qenë titulli Ligji për Familjen i Kosovës, kur mund të jetë thjeshtë Ligji për Familjen. Pra, të hiqen këto prapashtesa dhe ta lëmë emrin e saktë.

Kryetarja, tha se kemi diskutuar edhe në mbledhjen e fundit, kur e kemi dërguar këtë nismë të Komisionit për Legjislacion, në Drejtorinë për Standardizim dhe atë për Financa, se a ka implikime buxhetore. Siç e keni parë nuk ka as implikime buxhetore dhe as nuk bie ndesh me rregullat apo standardet. Ne do ta procedojmë për në Kryesinë e Kuvendit dhe pastaj Kryesia e dërgon për mendim në Qeveri. Por, sa i përket emërimit, unë pajtohem plotësisht nuk ka asnjë kuptim, sepse po tingëllon keq, por proceduralisht nuk lejohet, sepse është ndryshim-plotësim i ligjit. Ka shumë probleme në emërim, por përmbajtja megjithatë është jashtëzakonisht e nevojshme dhe duhet të procedohet, prandaj kërkoj mbështetjen e anëtarëve.

Hajdar Beqa, tha se përderisa jemi duke bërë plotësim dhe ndryshim, mund të gjejmë një rrugë ligjore që të ndryshohet titulli. Sepse, ne as në përmbajtje dhe as në numër të ligjit, nuk po ndryshojmë asgjë.

Kryetarja, tha se pas leximit të parë e bëjmë një amendament për ndryshimin e titullit.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që projektligji për ndryshim dhe plotësim e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, ta dërgojë në Kryesi për procedim të mëtejshëm.

6. Të ndryshme

A. Njoftim për Projekt-Rregulloren e Kuvendit

Kryetarja, tha se Rregullorja e punës ka kaluar në Kuvend dhe po ashtu edhe afati për amendamente ka përfunduar sipas afatit të paraparë.

Hajdar Beqa, tha se duhet të kemi konsensus nga të gjitha grupet parlamentare, sepse për t'u votuar në Kuvend duhen 80 vota. Disa amendamente duhet të mundohemi t'i harmonizojmë edhe në qëndrime, por edhe në përmbajtje.

Pas diskutimeve nga anëtarët e komisionit, u vendos që grupi punues t'i thërrasë të gjithë ata, të cilët kanë propozuar amendamente, ku janë gjithsej 30 amendamente dhe kur të shqyrtohen amendamentet e propozuesve, më pas grupi i punës të vazhdojë punën në finalizimin e saj, për ta proceduar në komision. Më datë 7.5.2018, të vazhdohet mbledhja e grupit të punues.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu